



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KRYESIA

Tiranë, më 03.04. 2018

Prot. 141

Vendim

Nr. 4, datë 03.04. 2018

**Për përbërjen e jurisë së çmimeve që Akademia e Shkencave akordon për 550-
vjetorin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut**

Mbështetur në Vendimin e Kryesisë së Akademisë së Shkencave nr. 24 datë 24.12.2017
“Për shpalljen e konkursit për veprat dhe botimin më të mirë shkencor kushtuar Gjergj
Kastriotit-Skënderbeut dhe epokës së Tij”, pika 3, me propozim të akad. Floresha Dado,
Kryetare e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike;

I. Caktohet përbërja e jurisë së vlerësimit të botimeve që paraqiten e nominohen për
konkursin e shpallur në Vititin Mbarëkombëtar në nderim të figurës së Gjergj Kastriotit-
Skënderbeut, të si vijon:

1. Prof. dr. Pëllumb Xhufi, kryetar;
2. Akad. Matteo Mandalà, anëtar;
3. Akad. Răzvan Teodorescu, anëtar;
4. Akad. Luan Starova, anëtar;
5. Akad.as Shaban Sinani, anëtar.

II. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të anëtarëve të jashtëm të jurisë për tri
mbledhje, duke përfshirë në këtë numër ceremoninë e shpalljes së fituesve, përballohen
nga buxheti i Akademisë së Shkencave. Mbledhja e parë e jurisë për miratimin e
kalendarit të saj të punës të bëhet brenda datës 20 prill 2018. Anëtarët e jurisë kanë të
drejtën e një honorari të arsyeshëm, që jepet pas përfundimit të konkursit.

III. Të nominuarit nga juria për çmimet e shpallur nga Akademia e Shkencave ftohen për një konferencë promovuese më 21-22 shtator 2018. Të nominuarit nuk mund të jenë më shumë se 10. Shpallja e fituesve do të bëhet publikisht. Shenja (simboli) i trofeut të fituesve do të jetë e posaçme.

IV. Specialisti i marrëdhënieve me jashtë dhe me publikun është koordinator i jurisë.

V. Drejtorja e bibliotekës shkencore dhe e botimeve cakton një specialist të saj në detyrën e sekretarisë së jurisë që e kryen këtë detyrë së bashku me asistenten e seksionit të shkencave shoqërore albanologjike .

VI. Ngarkohet sektori i financës që në bashkëpunim me seksionin e shkencave shoqërore e albanologjike të bëjë planifikimin e detajuar të kostos së përgjithshme të konkursit brenda datës 10 prill 2018 së bashku me “Planin e Masave”.

VII. Ngarkohet seksioni i shkencave shoqërore e albanologjike për njoftimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Vasil S. Tole

Sekretar Shkencor



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Vasil S. Tole". The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËRISË" at the top and "AKADEMIA E SHKENCAVE" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle. The signature is written in a cursive style and extends across the stamp.